

BUJAR XHAFERRI

8.44-1
2617

Shtund
të rri
pa ti treguar
të gjitha

P O E Z I

8SH-1
21417

Bujar Xhaferri

S'MUND
TË RRI
PA T'I TREGUAR
TË GJITHA



poezi

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

LIBRI IM I PARË NË VITRINËN E LIBRARISË

Libri im i vogël me vjersha
në vitrinën e librarisë,
midis librave të tjerë,
dukej sikur kish një drojtje të lehtë.
Si ai fshatari i skajshëm i kodrave
kur thirret në një mbledhje të rëndësishme
në qytet.

NË KËTO FUSHA ME BUKURI MAHNITËSE

Në këto fusha me bukuri mahnitëse
kam ardhur rrallë, nuk e di përse.

Kushedi ç'ka qenë: një takim zyrtar,
një mbasdite feste për grurin që u korr,
ose ndoshta një shëtitje e rrallë «turistike»
nëpër fushë.

Dhe tej, në skaj të fushës, kam humbur në
mendim,

se më ka hutuar bukuria e saj,
që s'ka mendjemadhësinë që kanë shpesh
bukuritë.

Jam ndalur ndanë mezhdave me fshatarë,
me fshatarët, krijuesit e kryeveprës «fushë»
i kam përshëndetur me kokë që larg,
siç përshëndet mësuesin e tij hijerëndë
shkollari i përskuqur, delikat!

Po ndonjëherë emrin tim të thjeshtë prej
qytetari,
çuditërisht, fshatarët e kanë thirrur me një
«shoku»

dhe unë jam hutuar më shumë në këtë çast,
siç hutohet njeriu nga lavdet e tepërta,

kur e ndien se meriton ca më pak.
Kam thënë me vete: mos hutimi im
prej bukurisë së fushës në mëngjes dhe në
mbremje,
prej të qeshurës njerëzore të fshatarit me
mikun

është marrë gabimisht si seriozitet zyrtari,
apo si një heshtje akademiku?
Jam trishtuar pak e prapë kam thënë me
vete:

Në këto fusha që kanë bukuri mahnitëse,
paskam ardhur rrallë, sa keq!

LUFTA E IMPROVIZUAR

Lojë.

Krisma pushkësh
tronditëse si në luftë.

Ushtarë që rendin drejt qendrës
së qytetit
me çanta në shpinë,

me kundragaz...

Nga katet e larta të pallateve
ca vajza ushtarë rrëshqasin me litar.

Ja dhe të plagosurit, mbi shpinat

e shokëve

tërhiqen me nxitim nga sheshi plot tym.

Nesër në reportazhin e gjatë të gazetës
fjala i «plagosur» do të futet në

thonjëza,

dhe fjala «armik»

dhe fjala «betejë»...

Adoloshentët e dinë se kjo s'është luftë,
se të plagosurit s'kanë plagë vërtet;

dhe atje ku po nxjerr tym një minë,
afrohen pa frikë,

afrohen pa tmerr

ashtu siç i afrohen një gjarpri
të madh,

në kabinetin e zoologjisë.

Një fëmijë në krahët e nënës qan
nga frika e krismave të pushkëve.

Po nëna që e mban fëmijën në krah
e puth,

e pushton

në krahët e saj e rrok dhe më fort:

— Mos u tremb, shpirt,

(hi, hi — qesh nëna)

dhe hop fëmija pushon!

Pastaj qesh, pastaj loz

i qetë, i sigurt

në krahët e nënës së tij

ZYRA E PËRGJEGJËSIT TË SEKTORIT
«TRI URA»

Kjo zyrë s'ka divanë,
as kolltukë, as sobë me motive,
ka vetëm një stol të gjatë prej dërrase
dhe dy tri karrige portative.
Nuk ka tapet të shndritshëm që të pushtojë
tërë dyshemenë,
që dikush kur vjen nga mesi i fushave
të shoh me dyshim këpucët,
i ka apo s'i ka të denja që të shkelë.
Nuk ka atë qetësi,
që shtiret ndonjëherë,
as pamje hijerëndë burokrati
dhe dikush që do të hyjë.
nuk matet te dera dhjetë herë,
se s'di gjendjen shpirtërore
të zyrtarit.
Po ka shumë vizitorë, shumë:
hyjnë bujq,
furrtarë,
kuzhinierë...
dhe secili prej tyre lë gjurmën e tij;

me çizme, me këpucë,

si ta sjellë rasti.

E ç'vlen një tapet i shndritshëm në një zyrë
përpara këtij mozaiku me gjurmë?

... Ka njerëz çdo ditë (ç'lumturi për një zyrë!)
që hyjnë të shkujdesur, pa ceremoni,
ashtu siç hyjnë miqtë në shtëpi.

LETRARI I RI NGA FSHATI

Fletoret e tij të thjeshta, dyzetqindarkëshe,
seç binin një erë të vjetër,

të vjetër,

siç binin stolitë e çmuara
të një nuseje të hershme fshati,
mbajtur prej vitesh në sepete.

Të gjitha vjershat shkruar me bukurshkrim;
me përkujdesje të veçantë për çdo varg,
siç shkruajnë ca mësues të zbardhur,

të moshuar,

fanatikë të paqortueshëm
të bukurshkrimit të saktë.

Vetëm emri i tij në fletën e

fundit —

shkruar shpejt e shpejt me një ndjenjë

turpi.

Dhe duart rrallëherë i mbante në xhep
se mbase ky ish një qëndrim mendjemadhi;
Dhe mes poetëve të qytetit në

kafene

nxitonte të paguante gjithmonë i pari.

TREGIMI I NJË ISH-PARTIZANI

... Dhe ia prenë këmbën
me një sharrë të drunjtë,
por kish akoma zemrën
për të mos rënë në gjunjë.

Që nga ai çast
edhe toka dhemb,
se shkel ai mbi të
vetëm me një këmbë!

Por nuk u hoq zvarrë
gjysëmulok me gjëmë.
Në këmbë mund të mbetesh
edhe kur je pa këmbë!

Dhe gjer tek jetë e bukur
nuk mbeti kurrë pas,
megjithëse me një këmbë
me kohën eci bashkë.

NË FOKUSIN E «SYRIT MAGJIK»

Syrin magjik e kish ëndërruar prej kohësh...

Dhe mikun që ia solli një ditë

e qerasi disa herë dhe e pagoi mirë.

E montoi syrin magjik dhe derës i vuri

kyçin nga brenda.

Ç'sy i çuditshëm, s'mund të bëjë pa një kyç!

Dhe qeshi pak lehtë:

ta bëjmë një provë,

një provë të thjeshtë.

Ç'do të bëjë ai që pas derës do të vijë

dhe troket, troket?

Dhe erdhi një mik i afërt i tij,

trokiti, trokiti...

Ai e shihte nga syri magjik dhe qeshte

mbytur.

hi, hi!

Kjo provë i ngjante një hileje

fëmijësh,

kur luajnë symbyllas,

kur ata që janë fshehur

qeshin me shokun që sillet për t'i gjetur.

Por prova e parë kish qenë kaq joshëse

saqë ai bëri të dytën,
të tretën...

Dhe hilja e provës së parë
u bë hile burri!

Tani, syri magjik në derën e tij
i ngjan syrit të gjallë të të zotit
të shtëpisë;

sy që ngriset, që tallet «hi, hi...»
dhe s'ka më nevojë të kombinojë me një kyç,
sepse është sy dhe kyç njëkohësisht!

PLAKU I DARSISË NË QYTETIN FUSHOR

Gjithçka i pëlqeu plakut në qytet:

«Ka bërë ndryshime të mëdha pazari!»

Në MA-PO-n e madhe bleu një këmishë,
bleu ca stofë për kostum dhëndërie,
se po i qasej dasma e djalit.

Bleu një kollare të gjelbër me rriga,
që ia la në dorë shitëses t'ia zgjidhte.

Në dyqanin e lodrave bleu një kalë,
se kuajt i donte nipi i madh.

Bleu ca peshqeshe për njerëzit e nuses;
peshqeshe të vogla,

simbolike pa «zarar»

«... E, iku koha e peshqesheve të mëdha!»

Gjithçka që bleu s'ish

kushedi se çfarë

mund t'i kish blerë dhe në dyqanin e

fshatit;

(«po kjo është dasmë, dasmë të shkretën
dhe dasma i dashka ca gjëra më të zgjedhura»)

Dhe shkoi i lumtur,

shkoi i gëzuar,

rrugës malore që ngjitej për në fshat.
Tek e ndiqja me sy unë pyesja veten:
Përse ca njerëz,
që shpesh kanë rrogë të mirë, kanë zyrë...
gëzohen rrallë, gëzohen pak?!

KREJT NDRYSHE KAM MENDUAR PËR NJERIUN E NJOHUR

Në fëmijërinë time të largët,
njeriun e njohur, me famë
e përfytyroja ndryshe nga njerëzit
që shihja rëndom në pazar.

Sipas meje, jetonte në luks
për meritat e mëdha që kishte,
dhe s'mund ta besoja kurrë
të ish banor i lagjes sime.

Të shkonte me bujë në stadium
midis rrëmujës së njerëzve,
të shtyhej në sportelin aty
për një biletë njëlekëshe!

Të shkonte pranë shtëpisë sime,
midis shokësh, me shaka e të qeshura
e t'i thoshë babait tim të vjetër:
— O xha filan, tungjatjeta!

B U K A

Rrallëherë na ka shkuar në mendje
të themi për bukën fjalë të bukura;
ndofta ngaqë dihet se buka
më e domosdoshmja është dhe më e çmuar.

Ose ndofta sepse urinë
s'e kemi ndier asnjë pasdite;
por vini veshin ç'pikëllim
ka ende në kujtimet e prindërve!

Padyshim, është lënduese për bukën
të thuash: «E fortë, e zezë...»
Cilido nuk është lodhur sa duhet
në e çmon kështu veç në tryezë!

Dhe kështu ka harruar, medet,
«mjerimin kafshatë që s'kapërdihet»...
Historia s'ka njohur ndonjëherë
një të varfër që ka lypur simite.



Ka harruar mundimin e bujkut,
pranë magjeve nënat tona të urta,
ndaj ai njeri nuk mund të ngrihet
gjer te dinjiteti që ka buka.

SHTËPIA E VJELËSES SË PAMBUKUT

Vjelësja Vasë ka një shtëpi të bukur,
një verandë plot hije dhe lule,
një korridor plot dritë,
shtruar me pllaka me motive.

... Në kuzhinë dy divanë,
një tryezë të shtruar me kujdes,
televizori «Iliria» mbi komodinë
mbuluar me një cohë të thjeshtë.
Vjelësja vjen nga mesi i fushave
dhe çlodhet me fëmijët në divan;
shfleton një libër ngadalë,
merr një sy gjumë...

E po mirë,

ç'ka këtu, — thoni ju, —
ndonjë lajm që të trondit?

Asgjë,

gjithçka është e zakonhtë,

mëse e zakonhtë,

po unë do të thosha se ka diçka

prekëse,

sepse Vasa është një fshatare,

Vasa është një vjelëse!

Kur hyj në shtëpinë e Vasës,
unë befaz gëzohem,
gjer tek pika e lotit gëzohem,
si ajo fëmija kurioze,
kur mëson ndofta në një tjetër
përrallë,
se Hirushja e varfër përfitonte nga drejtësia
këpucët e bukura,
këpucët e merituara.

NË KATIN E DYTË NË KAFE «LUSHNJA»

Në katin e dytë në kafe «Lushnja»
një burrë serioz shikon me çudi
djaloshin që është ulur në tryezën
në qoshe
dhe qesh me të dashurën aty përbri.
Djaloshi është nallbani i komunales së
qytetit,

Ti që e shikon ashtu me habi,
që herë tund kokën,

herë mërmërit,
mos thua me vete, mos thua vallë:
ku kafeneja moderne me kolltukë
dhe ku një nallban!
Po nallbani me kostumin e së shtunës,
me jakën e bardhë,

me gjestet prej të dashuri,
sa pak t'i kujton kuajt e mëdhenj,
hingëllimat e bujshme, darët,
zhurmën!...

Ai seç i thotë të dashurës dhe qesh...
Kushedi, i tregon ndonjë «histori»
dhe s'e ka mendjen, është krejt mospërfillës
ndaj atij që ende po e sheh me çudi.

HABIA E PANDRYSHUAR E MËSUESIT
TIM TË VJETËR

Ai shpeshherë habitej me mua;
më shikonte gjatë, me qortim
e keqardhje,

tundte duart me mërzi,
ngrinte vetullat lart:

— Po si kështu . . . po si, mor djalë,
a vjen nxënësi pa detyra në klasë?!

. . . Dhe përsëri habitej mësuesi im
i vjetër:

— Po si kështu,
të shëtisësh kaq vonë?!

Dhe prapë ngrinte supet e tij me qortim
dhe thosh me dhimbje frazën «se kuptoj!.. »
Tani përsëri kur e takoj rrallë,
më flet njëloj, plot mirësi e

qortim;
por, kur ndodh që unë t'i afrojmë një cigare,
stepet si dikur përsëri me habi:

— Po si, po pse, ti pike duhan?!

Dhe gjithmonë harron mësuesi im i
mirë
që tani unë jam plot tridhjetëvjeçar!

FQINJËT

Arta e vogël, trevjeçare
në çdo çast të ditës,
në çdo orë të ditës,
hyn në shtëpinë e fqinjit të saj...
Dhe luan, vrapon

dhe qeshet pastaj...

Ajo e di ku janë karamelet;
zgjat dorën e brishtë — s'hap dot një sirtar
dhe sheh rreth e rrotull si e kapur në faj.
Zemërohet një çast,

pikëllohet një çast,

(përpara zemërimit të fëmijës nuk ka
as burra të ngrysur, as burra të ashpër!)

Në prehër fqinji i thinjur e merr:

— Gjysh! — Arta e vogël atë e thërret.
Dhe gjyshi e puth, e puth, e përkëdhel,
se është kaq e vogël,

se është kaq e brishtë

dhe s'mund të kuptojë,
është gjysh apo është fqinj.

Po vetë, kur të rritet,

Arta e mirë

midis emrit «gjysh» dhe emrit

«fqinj»

s'do të dojë të dallojë asnjë ndryshim,
s'do të dojë ta prishë këtë sinonim!

SI NË FËMIJËRI

Sot do të vij të trokasë në shtëpinë
tënde,
siç vij zakonisht, kështu do të vij.
Do të vij sikur s'ka ndodhur asgjë
që të trishton e të mërzit.
S'do të vij si njeriu që vjen dhe
kërkon falje,
që kokën e ul e flet nën zë.

Dhe ti, e di, kështu do të më
presësh,
patjetër e ke harruar mërinë tani.
Dhe nuk do të habitesh,
nuk do të ngresh supet,
s'do të thuash e ngrysur:
— Ua, ç'njeri!
Vërtet, e dashur,
ndodhka kështu:
Si në miqësinë dhe mërinë e fëmijëve.

NDONJËHERË

Ndonjëherë të kam prekur në sedër,
të kam fyer pa fre,
të kam zemëruar
nga mendjelehtësia e njeriut
që dashuron me zjarr.

Nga asgjë tjetër!
Dhe me mospërfillje të shtirur
ndoshta të kam vështruar.
Por qenka e vërtetë se vetëm dashuria
të fal e të fal kaq herë!

TAVOLINA E REZERVUAR

Gjithmonë e kam parë me çudi
tavolinën e rezervuar në një kënd të kafenesë;
burrin krenar në krye të saj
e kam parë me çudi.

Ai flet me ton, shpjegon,
nënqesh,

kur dy tre të tjerë që i rrinë për bri
e dëgjojnë me kujdes...

Dhe flasin rrallë,
dhe skuqen shpesh!

Po përse, përse, kam bërtitur me vete,
këtu në kafene ku ka zhurmë,

ka humor,

ku ka miq, ku ka shokë...

aty në një kënd të ketë vartës të

përskuqur,

të ketë dhe një epror?!

NË PROVAT E KONCERTIT FESTIV

Në provat e koncertit festiv
kishte ardhur edhe vetë sekretari,
drejtori, inspektori,
shafi i seksionit...

Kishin ardhur
dhe disa artistë të qytetit.
Këngëtarët hynin dhe dilnin me
rregull,

pa gjeste humori, pa të qeshur.
Po erdhi një çast,
kur dolën në skenë fëmijët të
këndonin;

të qeshur, të bukur,
me fustane të shkurtra,
me pantallona të shkurtra;
shtynin me të qeshur

a me inat njëri-tjetrin,
se sikush në skenë
donte të ishte në vendin më të zgjedhur.
Me gjestet e tyre të vinte për të qeshur...
Qeshi edhe vetë sekretari,
edhe drejtori, edhe inspektori...

Vetëm njëri pas skenës,
u foli fëmijëve,
pak i skuqur nga zori:
— Na turpëruat, mor dreqër!

SHKOLLAR QË ECËN NËPËR FUSHA

Mos ec nëpër fusha me duar në xhepa,
duke fishkëlyer një motiv të largët,
të largët,

shkollar çapkën,
i krehur me kujdes,
që përskuqesh kur të shëh profesori në rrugë.

Fusha të lë pa mend!

Fusha ka prestigj më të madh se profesori.

Mos ec ashtu, pa përfillje;
fusha fyhet,

fyhet,
sidomos nga ty që nesër do të kesh një emër;
për shembull «agronom»,

«mësues»,

«shkrimtar»;

fusha fyhet si vajzë e brishtë, e bukur
që e ndien (sa shpejt e ndien)
kur ti i shkon përbri e sytë s'ia hedh!

Shkollar, që nesër ëndërron të kesh një emër;
s'dua të them famë, emrin e mirë,

ose «zënë e mirë», siç urojnë bujqit në mëngjes
dhe në mesditën e vonë,
mos ec ashtu nëpër fushë,
se mund të mbetesh anonim!

FËMIJA DHE MEDIOKRIT

Unë isha një çunak harrakat;
s'mësoja aritmetikë, gjeografi, histori...
S'më tërhiqnin mamuthët e lashtë me brirë,
dhe shpesh u fshihesha mësuesve në rrugë
nga frika se më ngrinin të nesërmen në mësim.
Po unë, çunaku harrakat,

i shkujdesur,
që mbaja nofkën e keqe «i prapë»,
që nënën e bëja të ishte e trishtë
dhe babanë të ishte i vrazhdë,
habitem tani: Vërtet, sa çudi!
Harrohesha shpeshherë te holli i

teatrit
ku shpesh dy tri burra diskutonin me zjarr:
— Ëhë, — thoshin — ky nuk është art!
... E ç'është kjo dramë pa konflikt,

pa kockë!
Ç'është ky fund absurd, abstrakt?...
E, ndonëse nuk isha një fëmijë i zellshëm,
këta i dëgjoja me atë zili të fëmijës,
që s'e kish babanë e tij aq të ditur...
Dhe atëherë mendoja:

kështu do të jenë

njerëzit që im atë i lëvdonte si të ngritur.
Por koha

dalëngadalë këta burra po i zvogëlonte,
i zbriste nga shkallët e vetlavdisë, pak nga pak.
Kështu, pak nga pak, ishte zvogëluar
dhe rruga nga shtëpia gjer te kinemaja
që në fëmijëri më dukej aq e gjatë.

Po, ishin mediokrit,

që dikur në fëmijëri
çuditërisht më bënë kaq lehtë kureshtar.
Atëherë kur s'më tërhiqnin mamuthët me brirë
ata më tërhoqën, ma mashtruan fëmijërinë!

Dhe besoj, ata në çdo kohë
do të mund të habisin vetëm fëmijë.

DITA KUR ERDHI CIRKU

Pa e përfillur seriozitetin e burrave,
dhe britmat trishtuese të gjysheve të
dhemshura,
fëmijët topolakë me pantallona të shkurtra
vrapuan në oborr me potere të madhe,
se erdhi makina e cirkut.

Erdhi

ariu sportist, akrobatët e çuditshëm,
klounët bullafiqë që qajnë dhe qeshin
dhe qeni i kuq që numëron gjer në njëqind!
(Ah, diplomacia e famshme e gjysheve,
sa keq,
sa keq,
mori fund!)

Të gjorat gjyshe u hutuan fare:

«Ç'e sollën dambllanë te derë e shtëpisë!».

Dhe hapën ballkonët, dhe hapën dritaret;
klithën me inat,

u kanosën, tundën gishtin

se do t'i mbyllnin me kyç,
do t'i linin me një këmbë...
Fëmijët atëherë qeshën më shumë
me «diktatin» e tyre
të çuditshëm, të rremë,
që s'di së paku të qëllojë një pëllëmbë!

LETRAT E DJALIT

Nga letrat e djalit që shkruante
nga larg

nëna mësonte gjithmonë
se ai ishte mirë,
se mirë e kish djalnin e vogël
dhe gruan po mirë...
Dhe kurrë s'mësoi nga letrat e djalit
se ai kish një hall,
se gruan e kish sëmurë,
se vetë kish qenë ca ditë në spital...
Po ndodhte që nëna të shihte ëndrra:
— Uh, ç'ëndërr kam parë;
e zeza, e zeza mos ka djali
gjëkafshë?

(Nga të gjitha telepatitë
telepatia e nënave duhet të jetë më e saktë!)
Veç djali asnjëherë s'i shkroi nga larg:
kam qenë pa qef,
kam pasur një hall...
Se ky do të ishte një mëkat i madh!

KËMISHA ME MOTIVE E DJALOSHIT PUNËTOR

Ishte një trill,
një trill njëzetvjeçari
këmisha me motive atë të diel;
këmisha me dy xhepa në formën e zembrës,
me spaleta te supet
dhe e ngushtë në bel.

Po djaloshi punon në pusët

e largëta

dhe vetëm të shtunave kthehet në shtëpi.
Ndaj ti, që e sheh gjithmonë me qortim,
mos kërce, mos nxito

ta quash modernist!

Pas ca kohësh këmisha me motive u zbeh;
disenjoja spaletat,

xhepat në formën e zembrës

u zbehën.

Dhe tani të gjitha,

të gjitha se si duken

mbi supet e imta të djaloshit punëtor;
si ca atavizma që gjithmonë harrohen,
që zbehen dhe zbehen gjithmonë.

S'MUND TË RRI PA T'I TREGUAR
TË GJITHA

Gjithmonë të kam vështruar gjatë
dhe pastaj prapë të kam vështruar
e prapë kam zbuluar diçka të re
në fytyrën tënde të imët;
diçka që s'e kisha parë një ditë më parë.
Dhe e kam kuptuar se vlejné pak
xhevahirët, tualeti,

gurët e çmuar,
kostumi i bukur i së dielës — pak!
Të kam vështruar gjatë, sa gjatë!
E pastaj të kam treguar ca gjëra,
që ndofta do t'i mbaja përjetësisht
të fshehta;

po s'kam mundur t'i bëjë ballë
shikimit tënd,
fytyrës sate të imët pa kurrfarë etikete.
(Çdo etiketë ka diçka të pasinqertë!)
Po si ndodhka kështu, e dashur,

si ndodhka?

Ti s'je perëndi,
që unë të trembëm para teje,

e si besimtarët e dikurshëm të rrëfhem!
Gjithmonë të kam vështruar gjatë,
gjatë;

dhe t'i kam treguar të gjitha,
të gjitha.

Po si, po pse?

Ndofta sepse dashuria
është si e vërteta.

NË SHTËPINË E SË FEJUARËS

Në shtëpinë e së fejuarës
nuk doja të hyja i hutuar,
si ai diletanti kur del në skenë;
dhe as i fryrë, rrethuar nga luksi,
«habi e miqve»,
me «perspektivën» dhe diplomën në xhep.
Desha të hyja thejsht,
si ai shoku i djalit të shtëpisë,
që nuk merr leje për të ndezur
një duhan.

N X Ë N Ë S I T

Të gjithë nxënësit ecin në rresht,
të shkujdesur,

të gatshëm për të vrapuar.

Dikush kthen kokën pas dhe qesh.

Dhe dikush tjetër, tinëz mësuesit,
vrapon korridorit mes për mes...

Po ja, veç njëri,

njëri prej tyre,

ecën anës murit pa e prishur

rreshtin.

(Kështu kish thënë mësuesja në mëngjes
dhe mësueses patjetër duhet t'i vësh veshin!)

Me këmishën e bardhë, të pastër, -

të pastër,

pak të gjerë te supet,

pak të lirë te beli,

këmishën që e ka blerë te dyqani

i fshatit.

C'më duket si burrë,

ky «mbrojtës» i rregullit

tek ecën i gëzuar,

tek ecën i shkujdesshëm,

anës korridorit pa e prishur rreshtin.

VIZITË PARA TË KORRAVE

Te mezhda e arës me grurë të verdhë,
ai zbriti nga makina buzagaz:
— E kemi grurin det sivjet, —
qeshi me zërin e plotë si babaxhan.
Dhe theri arës mes për mes,
xhaketën verore e hodhi mbi krahë,
me kapelen e madhe bënte fresk
dhe fshinte hera herës djersët mbi ballë.
Më tutje fshatarët po hapnin rrugët,
kur pas ca ditësh do të hynte kombajna:
— Si jeni, more shokë,

tungjatjeta, more shokë!

Ju lumshin duart, ju lumshin duart!
Dhe gjithë i qeshur, gjithë i gëzuar,
u tregonte me duar shokëve pas:
— Shihni, more, ç'grurë, e ndieni vallë?
Kjo është vërtetë antibllokadë!
Fërkonte duart, pëshpëriste ngadalë:
— Nesër do të dalim në raport faqebardhë!

Dhe ashtu i qeshur,
ashtu babaxhan,
pas kësaj vizite nëpër fushën e mbarë,
(e vetmja vizitë që e lidhte me grurin,
e vetmja kjo dhe tryeza e bukës)
u ngjit në makinë në sediljen e parë...

LODRA PËR MIQ

Kjo shtëpi i ka të gjitha,
të gjitha:
sixhade, komodina, bufe...
Bile edhe «bufa» mbi tavolinë,
edhe «mace» mbi komò!
Ç'lodra të bukura ka kjo shtëpi,
lodra që asnjëherë s'bëhet lojë me to!

Sepse fëmijët janë ndaluar rreptësisht
t'i prekin me dorë!
Miqtë që vijnë në këtë shtëpi
duhet t'i shohin të gjitha,
të gjitha:
dhe kukullën e madhe leshrazezë mbi tryezë,
dhe luanin krifëverdhtë mbi komò;
zonja e shtëpisë në këtë çast
është e lumtur,
dhe miqtë — të habitur.
Po unë do të thosha se miqtë
i ka të rrallë
një shtëpi kaq komode, me kaq lodra
e lodra...
Që, mjerisht, s'ka asnjë të prishur!

KOLLOVAR NË QYTET

Sapo shkel ai në qytet,
diku në një qoshe shkund xhaketën,
rrëzon me kujdes zbokthin nga jaka,
nxjerr nga xhepi pasqyrën e vogël
dhe kreh me kujdes flokët mënjanë.

Hedh dorën ngadalë
mbi flokun e ngrirë e të shtruar
dhe, kur bindet se asnjë cullufe s'e ka
jashtë standardit,
troket me guxim në shtëpinë e së fejuarës!

ÇAST DASHURIE NË PARK

Në periferi të qytetit,
në parkun e qetë,
errësira nuk ka aspak mister.
Të dashurit lëvizin qetë-qetë,
të mbrojtur nga syri kureshtar i njerëzve.
Dhe lozin pa drojtje,
ndjekin me të qeshura njëri-tjetrin.
Por vjen një çast,

(ndodh dhe kështu...)

kur fytyra e qeshur bëhet

serioze;

një shaka e tepruar.

një zënkë e vogël...

(Ka ca minuta kur të dashurit s'dinë

ç'thonë.)

— Ti më fyeve i pari,

ti shpesh më rëndon!...

Në rrugicën më lart kalimtari

i rrallë

shpejton hapat të ikë sa më larg...

RAKIA

Kur miqtë ndrinin shtëpinë,
në një gosti a një hall,
në sofrën e bukës së mirë
rakia ishte nderi i parë.

Po të ndodhte prej varfërisë
një pikë raki të mos kish,
atëherë nga damixhëni i fqinjit
patjetër do të bëhej hall për miqtë.

Rakia s'ka qenë e sarahoshëve
fatalë të dehur netëve...
(Burrat që e pinë rakinë
u hedhin përbuzje pijanecëve!)

Dhe as e atyre që si grackë
kompromisi e afrojnë rakinë;
nëse miku do të kushtonte kështu,
atëherë mallkuar miqësinë!

Që prej kohësh të moçme, të moçme
rakia ish e nderit të miqve,
dhe shpesh, kur miku mungonte,
sinonim miqësie ishte.

Baballarët tanë kur tregojnë
për një darkë, a një gosti,
në vend të fjalëve: «U bë një muhabet!»,
thonë shpesh: «Upi një raki!»

B A B A I

Më kujtohet shpesh babai,
kur shfletonte revistën «Hosteni»;
hiqte syzet optike një çast
dhe me zë të lartë shkulej së qeshuri.

Po një ditë mbi faqet e mesit
ai heshti ca çaste plot mërzi;
me hundë të madhe prepotenti
ish aty një shoku i tij.

Shoku që babai e mburrte mjaft,
që e ftonte shpesh në familje...
Pinin nga një gotë të dy bashkë
dhe flisnin gjer vonë për parimet.

E lexoi fejtonin gjer në fund,
dhe humbi në mendime, në hutim.
Ishte herë e parë që nuk qeshte
me «Hostenin» në dorë babai im.

KUR VDIQ MIGJENI

Nëse njeriu ka dy plagë,
njërën më të madhe se tjetrën,
do të ndiejë vetëm një dhembje,
plagën e madhe vetëm.

... Dhe lypësit do t'i kenë harruar
trotuarët atë ditë,

do të kenë harruar të lypin jetën.
Vetëm ndonjëri do të ketë lypur cigare
në ndonjë qoshe të qytetit...

Dhe fëmija trok e lakuriq,
nxënësi i varfër i Migjenit,
atë ditë, me siguri,
s'do ta ketë ndier urinë e mëngjesit!

LAVDIA E DILETANTIT

Ndofta ende s'i ka kapur të njëzetat,
po ka mësuar diçka nga biografia e Van Gogut,
diçka nga sjelljet protestante të Gojës,
diçka nga arti i saktë egjiptian...
Shpesh rri i mërzhitur,

i heshtur,

i shushatur;

ndofta shtiret,

për të imituar një piktor të njohur!

S'ka zor të lëvdohet,

ka dëshirë ta lëvdojnë.

Ka bindjen foshnjore se është mbi shokët.

Sapo mbaron një peizazh të

rëndomtë,

vizaton me kujdes një firmë të madhe:

aktin formal të autorësisë.

Nuk dua të tallem aspak

me mendjemadhësinë e padjallëzuar të

diletantit,

por dua që ai shumë shpejt

(siç ndodh shpesh me të talentuarit)

ta shohë me përbuzje atë firmë të madhe

dhe të qeshet me vetveten!

S'TË MARR INAT PËR NAZET E TUA

Nuk je e bukur,
s'ke sy të mëdhenj,
as qerpikë të gjatë dhe as bel
të hollë,

që të «çmendësh» djemtë.

Po në mes shoqeve je kaq çamarroke,
lodërtare,

fjalëshumë,

kanakare.

«Ua!», — habitesh kur dikush të ngacmon,
rrudh ballin, ngrys vetullat,

(improvizon inatin)

dhe pastaj me përtesë e çon kokën mënjanë,
si të ishe bukuroshja e përrallave me famë!

Po ti s'je e bukur,

s'ke sy të mëdhenj,

as qerpikë të gjatë që të «çmendësh» djemtë;
megjithatë ke hiret, ke lodrat

e tua,

bullafiqe e qeshur,

çapkëne llafazane...

S'të marr inat për nazet e tua,

s'të shoh me habinë «Ç'e vret dhe kjo lart?!»

Vajzë nazemadhe që s'je e bukur

dhe, sidomos, s'je e shëmtuar aspak!

SHIKUESI I VOGËL I KONKURSIT TË TV-së

Gjithmonë e shihte televizorin
në heshtje;
buzëqeshte me vete,
priste në ankth;
kur moshatarët e tij përgjigjeshin
sakt,
ngrihej në këmbë, përplaste duart ...
Dhe ndodhte shumë rrallë të kishte trishtim,
të belbëzonte me vete me keqardhje
pak,
kjo ndodhte kaq rrallë,
vetëm atëherë,
kur ndonjë nga fëmijët përgjigjej gabim.
Po sot kish ndodhur ndryshe,
krejt ndryshe,
megjithëse s'kish pasur përgjigje të pasakta,
dhe deri në pyetjen e fundit
skuadrat
si zakonisht kishin pikë të barabarta.
Dhe djali kurioz,
(jo kaq i vogël sot),

shikuesi i përhershëm, çudi,
u hutua,
s'klithi për fituesit me gëzim si më parë,
s'u çua në këmbë të përplaste duart!
S'i hiqej nga mendja drejtuesja e konkursit;
përzemërsia e saj: «Hë, pra, fëmijë...

... kujdes, mos gaboni, mendohuni mirë...
Është fjala për një figurë të shquar,
të shquar

që ka kënduar natyrën,
fushat, bagëtinë...!»
Ç'i kish mbetur në mendje kjo përzemërsi,
dhe prapë kish menduar për pikët
e barabarta,

për fituesit e qeshur,
për të mundurit pak të trishtë,
që, si zakonisht, e humbën konkursin,
me diferencën... vetëm një pikë!

S'KAM ARDHUR TË MA SHOHËSH
MËRZINË

Kur kam genë rastësisht i mërzitur,
i mbushur me zemërimin e madh
njerëzor,

prej një zënke të rastit,
prej një loje fjalësh,
prej një kurthi burokratik të kurdisur në
prapashpinë,

e dashur, kam ardhur tek ty.
S'kam ardhur të ngushëllohem,
të qahem,
të shfryj.

s'kam ardhur të ma shohësh mërzinë
e të më thuash me një zë të trishtë:
— Po ç'ke sot, ç'ke kështu?!

Po jam çuar me vrull,
kam ecur pa kuptim
dhe rruga vetvetiu më ka sjellë te ty.
Dhe në çast jam ndier i qetë,
i qetë.

Dhe duart, dhe buzët s'më janë dridhur
nga zemërimi;

dhe s'kam folur mbrapsht me inat e me mllef.
(E dashur, dashuria paska lindur te
njeriu

të shërojë plagët e tij!)
Sytë e tu të mëdhenj, të butë,
fëmijnorë

pa hakmarrje,
pa inat,
pa zemërim

kanë qenë për mua «antidodë» atë çast
siç është racioni falas i qumështit
për punëtorët e minierës,
për tipografët...

turn pas turni kur «toksikohen» pak!

PËRMBAJTJA

Libri im i parë në vitrinën e librarisë	3
Në këto fusha me bukuri mahnitëse	4
Lufta e improvizuar	6
Zyra e përgjegjësit të sektorit «Tri ura»	8
Letrari i ri nga fshati	10
Tregimi i një ish-partizani	11
Në fokusin e syrit magjik	12
Plaku i Darsisë në qytetin fushor	14
Krejt ndryshe kam menduar për njeriun e njohur ...	16
Buka	17
Shtëpia e vjelëses së pambukut	19
Në katin e dytë në kafe «Lushnja»	21
Habia e pandryshuar e mësuesit tim të vjetër	22
Fqinjët	23
Si në fëmijëri	25
Ndonjëherë	26
Tavolina e rezervuar	27
Në provat e koncertit festiv	28
Shkollar që ecën nëpër fusha	30
Fëmija dhe mendiokrit	32
Dita kur erdhi cirku	34
Letrat e djalit	36
Këmisha me motive e djaloshit punëtor	37
S'mund të rri pa t'i treguar të gjitha	38
Në shtëpinë e së fejuarës	40
Nxënësit	41

Vizitë para të korrave	42
Lodra për miq	44
Kollovar në qytet	45
Çast dashurie në park	46
Rakia	47
Babai	49
Kur vdiq Migjeni	50
Lavdia e diletantit	51
S'të marr inat për nazet e tua	52
Shikuesi i vogël i konkursit të TV-së	54
S'kam ardhur të ma shohësh mërzinë	55

Xhaferri. B

S'mund të rri pa t'i treguar të gjitha.
Poezi (Red.: S. Dajo) T., «Naim Frashëri»
1986.

60 f.

(B.m.).

(B.v.) 891.983-1

Xh 17

Recensentë:

**Razi Brahimi,
Shaban Murati,
Remzi Lani**

Tirazhi 1000 kopje Format 70x100/32 Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK · Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1986